



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Politikën e Jashtme

Tiranë më, 22.11.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020” (Shqyrtimi në parim)

HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, në mbledhjet e tij të datës 14 dhe 22 nëntor 2019.

Relator për këtë projektligj ishte deputeti Z. Ervin Bushati.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin ishin Ministri i Shtetit për Diasporën dhe përfaqësues nga institucione në varësi të tij si dhe Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa i takon aspektit procedural, duke qenë se Komisioni për Politikën e Jashtme nuk është komisioni përgjegjës, ky komision e shqyrton këtë projektligj sipas fushave të tij të përgjegjësisë. Në seancat e zhvilluara komisioni shqyrtoi në parim projekt buxhetin e parashikuar për Ministrinë e Shtetit për Diasporën dhe për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme.

QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektbuxheti i vitit 2020 ka si qëllim të mbështesë reformat e ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritetit në Bashkimin Europian si dhe planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale të cilat do të

vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë.

Projektbuxheti 2020 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë, për thellimin e reformës në drejtësi, për vazhdimin e mbështetjes së reformës administrativo-territoriale dhe reformave të tjera të decentralizimit.

Programimi i të ardhurave për vitin 2020, mbështet synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsolidim fiskal, reduktim të deficitit buxhetor dhe borxhit publik dhe bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal nëpërmjet implementimit të projektit të fiskalizimit dhe minimizimit të informalitetit në ekonomi, duke mbështetur rritjen ekonomike të qëndrueshme.

Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar trajektoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB.

Rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi nivelin prej 4% përgjatë viteve 2020-2022.

Defiçiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Për të pestin vit radhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.7% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të pestin vit radhazi.

MINISTRIT SHTETIT PËR DIASPORËN

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën në mbledhjen e datës 14 nëntor 2019. Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua nga Ministri Z. Pandeli Majko dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Misioni i ministrit të Shtetit për Diasporën është të përfaqësojë e të nxisë politikën e bashkëpunimit dhe të ndërveprimet me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.

Shpenzimet e parashikuara në projekt buxhetin e vitit 2020 do t'u shpërndahen institucioneve që mbështesin misionin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën duke ndihmuar dhe kontribuar konkretisht në çëshjet që lidhen me Diasporën, siç janë: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Në parashikimin e buxhetit 2020 shpenzimet e parashikuara për këto institucione, janë përfshirë, në një program të vetëm financiar "Shërbime për Diasporën", në të cilin janë parashikuar 204,950,000.00 lekë.

Numri i punonjësve që është parashikuar për institucionet është :

Agjencia për diasporën: 15 punonjës

Agjencia Kombëtare për Diasporën është krijuar me Ligjin nr 115/2017 "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës". Kjo agjenci ka si qëllim nxitjen dhe zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen në jetën kulturore, social – ekonomike dhe politike në Diasporë si dhe synon zbatimin e politikave shtetërore dhe krijimin e instrumentave të dobishëm në ndihmë të qeverisë dhe aktorëve të tjerë për të fuqizuar bashkëpunimin me diasporën.

Qendra e Botimeve për Diasporën: 15 punonjës (2 më shumë se numri i punonjësve për vitin 2019)
Kjo qendër është krijuar me Vendimin nr 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e qendrës së botimeve për diasporën” dhe realizon një sërë funksionesh sa i takon botimit, krijimit të aksesit, bashkrendimit të punës apo koordinimin me institucionet sa i takon teksteve dhe botimeve për Diasporën.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët : 12 punonjës

Kjo qendër u krijua me VKM Nr.601, datë 04.09.2019, “Për Krijimin e “Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”. Objektivi kryesor që synohet të arrihet nëpërmjet “Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët” si një mekanizëm për rritjen e Bashkëpunimit të Studiuesve vendas dhe të Diasporës që mbështesin zhvillimin e studimeve të lidhura me botën shqiptare.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.601, Datë 04.09.2019, “Për Krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”. Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2020. Në projekt buxhetin e paraqitur në kuvend për vitin 2020 është parashikuar numri i punonjësve (12 punonjës) për Qendrën për Studimet dhe Publikimet për Arbëreshët por nuk është parashikuar buxheti për këtë institucion.

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në mbledhjen e datës 22 nëntor 2019. Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua nga ministri në detyrë, Z. Gent Cakaj. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Z. Cakaj në prezantimin e tij sqaroi se projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është pjesë e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm të MEPJ, për periudhën 2020-2022. Ai është hartuar në funksion të mbështetjes së aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu dhe misionet diplomatike dhe postet konsullore. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara në programin e Qeverisë për politikën e jashtme, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian.

Buxheti total i MEPJ për vitin buxhetor 2020 është në vlerën 3.636.380 miliardë lekë dhe rritja buxhetore në krahasim me vitin 2019 është në vlerën 455.880 milion lekë. Kjo rritje e buxhetit lidhet vetëm me mbulimin e kostove të aktiviteteve që do të organizohen me rastin e kryesimit të OSBE-së.

Projekt- Buxheti i vitit 2020 i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme synon realizimin e objektivave kryesore të aktivitetit të saj, të cilat janë:

1. Integrimi Evropian

Buxheti që është planifikuar të akordohet për vitin 2020, do t'i shërbejë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për realizimin e këtyre prioriteteve:

- Hapja e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian;
- Garantimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale në funksion të procesit të negociatave të anëtarësimit.

2. Kryesimi me sukses i OSBE

Gjatë vitit 2019 u alokuan kapacitetet dhe fondet e nevojshme për ngritjen e Task Forcës pranë MEPJ dhe Njësisë pranë Misionit në Vjenë. Gjithashtu, me këto fonde u organizua me sukses në Tiranë dhe Konferenca Mesdhetare.

Si kryesuese e radhës e OSBE Shqipëria duhet të organizojë një sërë aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2020 të cilat kanë dhe kostot e tyre financiare të parashikuara në buxhetin këtij viti.

3. Kandidatura e Shqipërisë për një vend të përkohshëm në KS/OKB 2022-2023

Gjatë vitit 2020 do të vijojë komunikimi intensiv me vendet anëtare të OKB për të maksimalizuar mbështetjen për kandidaturën e vendit tonë për një vend jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit. Kjo do të përfshijë, në varësi të ecurisë së procesit, organizimin e vizitave, përfshirë në vendet e Kontinentit Afrikan. Në këtë kontekst parashikohet dhe hapja e një ambasade të RSH në Afrikë (mund të jetë në Adis Ababa, Etiopi duke qene se këtu kanë selinë disa organizata ndërkombëtare si Unioni Afrikan). Aktualisht vendi ynë ka vetëm një përfaqësi diplomatike në Afrikën e Veriut/Egjypt).

Paralelisht do të vijojë ngritja dhe përgatitja e strukturave në MEPJ dhe Misionin e RSH në Nju Jork, ku do të krijohet një Task Forcë e posaçme. Në këtë kontekst do të realizohen trajnime të diplomateve mbi problematikat specifike të Këshillit të Sigurimit, krijimi i një soft-i me një data base në MEPJ, ku të pasqyrohen qëndrimet dhe votimet e vendit tonë për çështje të ndryshme që trajton Këshilli i Sigurimit.

4. Bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet me fqinjët dhe shqiptarët në rajon

Marrëdhëniet dypalëshe me vendet e rajonit dhe vendet fqinje, bashkëpunimi rajonal në kuadër të Ballkanit Perëndimor, si dhe angazhimi në nismat rajonale janë elementë parësorë të aksionit diplomatik të MEPJ. Të para në kuadër të proceseve integruese euro-atlantike, aksioni rajonal diplomatik shqiptar merr një rol të veçantë, duke patur parasysh se është pikërisht ky rajon për të cilin zëri i Shqipërisë dëgjohet më së shumti nga partnerët ndërkombëtarë dhe nga kancelaritë kryesore në botë. Në këtë rajon Shqipëria zhvillon politikën e saj të jashtme mbështetur në pesë partneritete strategjike: Kosovë, Itali, Turqi, Greqi, Kroaci, të cilat përbëjnë shumicën dërmuese të partneriteteve strategjike që vendi ynë ka me vendet e tjera.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2020, MEPJ do të punojë për thellimin e dialogut politik me shtetet e rajonit duke zhvilluar më tej tërësinë e marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partneret strategjike, vendet fqinje si dhe vendet mike e aleate.

5. Diplomacia ekonomike

Objektivi kryesor në drejtim të diplomacisë ekonomike për vitin 2020 është forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë ekonomike, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik, tregtar me partnerët tanë ndërkombëtarë dy dhe shumëpalësh.

Objektivi i MEPJ është realizimi i rolit pro aktiv i korpusit diplomatik në qasje, tërheqje dhe angazhime ndaj investitorëve potencial në sektorët e synuar. Aplikimi i një diplomacie operative, të orientuar drejt rritjes me një qasje më gjithëpërfshirëse dhe më agresive për të gjurmuar/ndjekur IHD-të dhe eksportet, tërhequr njohuri të reja në Shqipëri.

6. Diaspora

Gjate vitit 2020 do te vijoje puna për:

- Krijimin e Regjistrimit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucione ndërkombëtare me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t'i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë.
- Hartimin e një Strategjie të Diplomacisë Digjitale që do të kontribuojë në strukturimin më të mire të punës për një Shqipëri më të njohur ndërkombëtarisht dhe me një imazh të përmirësuar pozitiv. Zbatimi i këtij projekti synon promovimin e imazhit, potencialeve dhe mundësive ekonomike, kulturore, natyrore, fizike dhe njerëzore të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.
- Promovimin e imazhit të Shqipërisë dhe të shqiptarëve që jetojnë në Diasporë nëpërmjet “COLOURS OF ALBANIAS 2020”.
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të emigrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit të ligjit për të drejtën e votimit të emigrantëve ende në proces).

7. Shërbimi konsullor

Siç u përmend dhe më lart gjatë vitit 2020 pritet të hapen dhe bëhen funksionale me fondet e alokuara për vitin 2020 dhe kapacitetet njerëzore të MEPJ disa përfaqësi diplomatike dhe konsullore për disa prej të cilave janë marrë vendimet përkatëse nga KM:

- a. Ambasada në Kanberra (VKM)
- b. Misioni i Posaçëm në Kiev (VKM)
- c. Ambasada në Adis Ababa
- d. Konsullata e Përgjithshme në Ulqin (VKM pritje)
- e. Konsullata e Përgjithshme në Preshevë
- f. Konsullata e Përgjithshme në Manastir

Fuqizimi i Karrierës Diplommatike në Misione - Menaxhimi i burimeve njerëzore ka synuar përmirësimin e përfaqësimit me profesionistë të karrierës, duke minimizuar emërimet nga jashtë sistemit.

Vlerësimi, motivimi, zhvillimi i karrierës Diplommatike – Ky proces shoqërohet me mbulimin e shpenzimeve financiare për shkak të rritjes në grada diplomatike sipas Legjislacionit për Shërbimin e Jashtëm.

Orientimi i politikës së jashtme për vitin 2020 do të jetë zgjerimit dhe intensifikimi i marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, Evropën dhe SHBA, si dhe vende te tjera të botes. Gjithashtu, ne fokus do të jetë thellimi i dialogut politik me institucionet evropiane dhe avancimi i mëtejshëm ne procesin e integritimit evropian me synim hapjen e negociatave për anëtarësim, përfaqësim aktiv në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale ku Shqipëria aderon, në forume shumëpalëshe dhe koalicione ndërkombëtare ku ndajmë interesa dhe vlera te përbashkëta.

DISKUTIMET NË KOMISION

Ministri i Shtetit për Diasporën

Në mbledhjen e 14 nëntorit, u prezantua në parim projekt buxheti për Ministrin e Shtetit për Diasporën. Ministri, Z. Majko, sqaroi se risia që sjell projekt buxheti i vitit 2020 është Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, e cila do të shërbejë si një mekanizëm për rritjen e bashkëpunimit të studiuesve vendas dhe të diasporës që mbështesin zhvillimin e studimeve të lidhura me botën shqiptare, duke e çuar numrin e agjencive që bashkëveprojnë në funksion të diasporës në 4. Këto agjenci do të mbështesin misionin e Ministrit të Shtetit për Diasporën duke ndihmuar dhe kontribuar konkretisht në çështjet që lidhen me shqiptarët jashtë vendit.

Deputetët, anëtarë të Komisionit shprehën vlerësimin e tyre për misionin e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe kërkuan informacion mbi realizimet e buxhetit të vitit 2019 dhe objektivat për vitin 2020.

Z. Majko, pasi sqaroi rëndësinë e përmbushjes së objektivave për vitin 2020, shprehu rezervat e tij lidhur me mungesën e kategorizimit të zërave buxhetorë sipas agjencive dhe parashikimin e buxhetit në një zë të përbashkët. Ministri theksoi se kategorizimi në një zë të vetëm “Shërbime për Diasporën”, mund të lërë vend për keqkuptime, duke qenë se shërbime për diasporën ofrojnë edhe ministri të tjera, si për shembull Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ministri kërkoi gjithashtu akordimin e **vlerës shtesë prej 17 milionë lekësh** në buxhetin e parashikuar, me qëllim mbulimin e shpenzimeve për Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Për sa më sipër u shpreh dakord edhe Zv. Ministri për Ekonominë dhe Financat, i cili e cilësoi kategorizimin e zërave një çështje teknike, e cila mund të rregullohet gjatë shqyrtimit nën nën të projektligjit.

Kryetarja e Komisionit, duke theksuar rëndësinë e çështjeve që lidhen me Diasporën dhe nevojën për të mbështetur nismat e ministrit përgjegjës, së bashku me deputetët, anëtarë të komisionit u shprehën të gatshëm për të konsideruar dhe vlerësuar kërkesat e Z. Majko.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Në mbledhjen e datës 22 nëntor, Z. Cakaj gjatë prezantimit të tij sqaroi se projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është pjesë e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm të MEPJ, për periudhën 2020-2022.

Projekt-buxheti është hartuar në funksion të mbështetjes së aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu dhe misionet diplomatike dhe postet konsullore. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara në programin e Qeverisë për Politikën e jashtme, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian.

Ministri në detyrë sqaroi se buxheti i MEPJ do të operojë me 4 Programe Buxhetore:

- 1- Planifikim, menaxhimi dhe Administrimi
- 2- Mbështetje Diplomatike Jashtë Shtetit
- 3- Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MEPJ
- 4- Mbështetja Instrukionale për Procesin e Integrimit.

Relatori, Z. Ervin Bushati prezantoi për komisionin objektivat e politikës së jashtme për vitin 2020. Ai sqaroi se në parashikimin e buxhetit 2020 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore është

parashikuar zëri “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme” me një total të shpenzimeve buxhetore prej 3,636,380 miliardë lekësh.

Z. Bushati sqaroi se rritja buxhetore, për vitin 2020, në krahasim me vitin 2019 është në vlerën 455.880 milion lekë, rritje e cila lidhet vetëm me mbulimin e kostove të aktiviteteve që do të organizohen me rastin e kryesimit të OSBE-së. Ndërkohë, të gjitha synimet dhe objektivat e Shërbimit të Jashtëm, pavarësisht mos rritjes së tavanëve buxhetore në krahasim me vitin e kaluar, janë parashikuar të mbulohen falë një mirë administrimi të burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore në dispozicion për vitin 2020.

Kryetarja e komisionit kërkoi sqarime dhe detaje lidhur me planifikimet për kryesimin e OSBE-së, dhe shprehu shqetësimin mbi realizimin e objektivave me buxhetin e vendosur në dispozicion. Deputetët, anëtarë të komisionit, mbështetën shqetësimin e kryetares duke u treguar të gatshëm të rishqyrtojnë kërkesat e ministrisë, në ndihmë të realizimit sa më të plotë, të një ngjarjeje kaq të rëndësishme për Shqipërinë, siç është kryesimi i OSBE-së.

PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal, projektligji përbëhet nga 3 krerë dhe 21 nene.

Në përfundim, deputetët e komisionit, pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2020 për secilën nga ministritë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, miratuan në parim me shumicë votash projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

RELATOR

ERVIN BUSHATI

KRYETARE

MIMI KODHELI



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”
(Shqyrtimi nen për nen)

• **HYRJE**

Komisioni për Politikën e Jashtme, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, në mbledhjet e tij të datës 21 dhe 25 nëntor 2019.

Relatore për këtë projektligj ishte deputetja Znj. Eglantina Gjermani.

Në mbledhjet e komisionit për shqyrtimin e projektligjit nen për nen ishin të pranishëm Ministri i Shtetit për Diasporën Z. Pandeli Majko dhe përfaqësues të kabinetit të ministrit, Z. Armand Skapi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj. Ilda Dega, drejtore për buxhetin dhe financat pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

• **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa i takon aspektit procedural, duke qenë se Komisioni për Politikën e Jashtme nuk është komision përgjegjës, ky komision e shqyrton këtë projektligj sipas fushave të tij të përgjegjësisë. Në seancat e zhvilluara komisioni shqyrtoi nen për nen projekt buxhetin e parashikuar për Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme.

• **PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRIN E SHTETIT PËR DIASPORËN**

Komisioni shqyrtoi nen për nen projektbuxhetin e Ministrit të Shtetit për Diasporën në mbledhjen e datës 21 nëntor 2019. Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua nga Ministri Z. Pandeli Majko.

Ministri, ritheksoi nevojën për ndryshime në kategorizimin e zërave të parashikuar në projekt buxhetin e vitit 2020 nga një zë i vetëm “Shërbime për diasporën” në 4 zëra të kategorizuar sipas agjencive

përkatëse: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Në projekt buxhetin për vitin 2020 shpenzimet e parashikuara për këto institucione, janë përfshirë, në një program të vetëm financiar “Shërbime për Diasporën”, (grupi 87), në të cilin janë parashikuar **204,950,000.00** lekë, të cilat përfshijnë: Shpenzime Korrente (zërat 600, 601, 602) dhe Investime (zëri 231), në ndryshim nga buxheti i vitit 2019, ku zërat ishin kategorizuar sipas agjencive përkatëse.

Numri i punonjësve që është parashikuar për institucionet është :

Agjencia për diasporën: 15 punonjës

Qendra e Botimeve për Diasporën: 15 punonjës (2 më shumë se numri i punonjësve për vitin 2019)

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët : 12 punonjës

(Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.601, Datë 04.09.2019, “Për Krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”. Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2020. Në projekt buxhetin e paraqitur në kuvend për vitin 2020 është parashikuar numri i punonjësve (12 punonjës) për Qendrën për Studimet dhe Publikimet për Arbëreshët por **nuk është parashikuar buxheti** për këtë institucion.)

• PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në mbledhjen e datës 25 nëntor 2019. Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua nen për nen nga Sekretari i Përgjithshëm Z.Armand Skapi. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjatë prezantimit Z. Skapi rikujtoi për Komisionin objektivat kryesore të MEPJ për vitin 2020, të cilat janë:

1. Integrimi Evropian
2. Kryesimi me sukses i OSBE
3. Kandidatura e Shqipërisë për një vend të përkohshëm në KS/OKB 2022-2023
4. Bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet me fqinjët dhe shqiptarët në rajon
5. Diplomacia ekonomike
6. Diaspora
7. Shërbimi konsullor

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të operojë me 4 Programe Buxhetore:

- 1- Planifikim, menaxhimi dhe Administrimi
- 2- Mbështetje Diplomatike Jashtë Shtetit
- 3- Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MEPJ
- 4- Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritimit.

Z. Skapi sqaroi se buxheti total i MEPJ për vitin buxhetor 2020 është në vlerën **3.636.380 miliardë** lekë dhe ritja buxhetore në krahasim me vitin 2019 është në vlerën 455.880 milion lekë. Kjo rritje e buxhetit lidhet vetëm me mbulimin e kostove të aktiviteteve që do të organizohen me rastin e kryesimit të OSBE-së.

- **DISKUTIMET NË KOMISION**

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministri i Shtetit për Diasporën i propozoi Komisionit shpërndarjen e buxhetit të planifikuar, si në vitin 2019, me kategorizimin si më poshtë:

- **Për Agjencinë Kombëtare të Diasporës** në buxhetin e vitit 2020 propozohet të ruhet niveli i shumës prej 81,500,000.00 lekë sa dhe vlera e vitit 2019 sipas tabelës Nr.1

Buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës do të përbëhet nga shpenzimet për paga 16,500,000.00 lekë, shpenzime korrente 62,000,000.00 lekë dhe 3,000,000.00 lekë investime kapitale.

Tabela Nr.1

Zëri	2020
Shpenzime për paga	16,500,000.00
Shpenzime korrente	62,000,000.00
Investime	3,000,000.00
Totali	<u>81,500,000.00</u>

- **Për “Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”** në buxhetin e vitit 2020 propozohet të jenë shpenzimet 54,230,849.00 lekë të ndara sipas tabelës Nr.2.

Në këto shpenzime janë ato të parashikuara me Projektin “Diaspora për Zhvillim” të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.611, Dt.17.10.2018, Projektin “Diaspora Shkencore si një faktorë ndryshimi në procesin e Integrimit Evropian të Shqipërisë” të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 321, Datë 15.05.2019 dhe Projektin “Dhoma e Biznesit të Diasporës-Krijimi dhe Nxitja e Investimeve të Diasporës në Shqipëri ” të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.514, Datë 19.07.2019.

Për vitin buxhetor 2020 për projektin “Diaspora për zhvillim” është miratuar vlera 32,367,559.00 lekë si shpenzime kapitale, për projektin “Diaspora Shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e Integrimit Evropian të Shqipërisë” është miratuar vlera 18,863,290.00 lekë si shpenzime kapitale dhe për projektin “Dhoma e Biznesit të Diasporës-Krijimi dhe Nxitja e Investimeve të Diasporës në Shqipëri” është miratuar vlera 3,000,000.00 lekë si shpenzime kapitale.

Tabela Nr. 2

Projektet:	Buxheti 2020, Shpenzime Kapitale Totale
Projekti: Diaspora për Zhvillim	32,367,559.00

Projekti: Diaspora Shkencore	18,863,290.00
Projekti: Dhoma e Biznesit për Diasporën	3,000,000.00
Totali	<u>54,230,849.00</u>

- **Për “Qendrën e Botimeve për Diasporën”** për buxhetin e vitit 2020 propozohet të ruhet i njëjti nivel i shpenzimeve si në vitin 2019 në shumën prej 56,500,000.00 lekë të ndarë sipas tabelës Nr.3.

Qendra e Botimeve për Diasporën ka nisur funksionimin administrativ në datë 1 janar 2019 në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 469 Datë 26.07.2018 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, ndërsa struktura e saj është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.76, datë 15.04.2019.

Tabela Nr.3

Zëri	2020
Shpenzime për paga	15,600,000.00
Shpenzime Korrente	24,900,000.00
Shpenzime Kapitale	16,000,000.00
Totali	<u>56,500,000.00</u>

- **Për “Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”** për buxhetin e vitit 2020 propozohet që shpenzimet të jenë 30,044,660.00 të ndara sipas tabelës Nr.4.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.601, Datë 04.09.2019, “Për Krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”. Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2020. Në projekt buxhetin e paraqitur në kuvend për vitin 2020 është parashikuar numri i punonjësve (12 punonjës) për Qendrën për Studimet dhe Publikimet për Arbëreshët por nuk ishte parashikuar buxheti për këtë institucion.

Tabela nr.4

Zëri	2020
Shpenzime për paga	17,628,660.00
Shpenzime Korrente	8,936,000.00
Shpenzime Kapitale	3,480,000.00
Totali	<u>30,044,660.00</u>

Ministri Z. Majko, me miratimin në parim edhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave i propozoi Komisionit për Politikën e Jashtme t'i përcjellë Komisionit përgjegjës kërkesën për akordimin e vlerës shtesë prej **17,325,509.00** lekë për buxhetin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Kjo vlerë plotëson parashikimin buxhetor të domosdoshëm për funksionimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Relatorja, deputetja Znj. Gjermani, mbështeti propozimet e Z. Majko, duke theksuar rëndësinë e kategorizimit të zërave në projekt-buxhet, me qëllim shmangien e përplasjes mes shërbimeve për diasporën që ofron Ministri i Shtetit për Diasporën me shërbimet që ofrojnë ministrinë e tjera.

Deputetët, anëtarë të Komisionit vlerësuan veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Diasporën, dhe shprehën mbështetjen e tyre për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Kryetarja e Komisionit, duke theksuar rëndësinë e çështjeve që lidhen me Diasporën dhe nevojën për të mbështetur nismat e ministrit përgjegjës, së bashku me deputetët, anëtarë të komisionit u shprehën të gatshëm për të konsideruar dhe vlerësuar kërkesat e Z. Majko, si dhe për t'ia përcjellë ato komisionit përgjegjës.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Sa i takon kërkesave për shtesa apo ndryshime nga *Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*, përfaqësuesit e kësaj ministrie kërkuar vetëm disa ndryshime në tavanet buxhetore brenda vlerës totale të buxhetit, si në tabelën më poshtë:

Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Deg. Thesarit	Debiti
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme					
<i>Pakësohet</i>					
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	01	01120	6050000	3535	120,000 mijë lekë
<i>Shtohet</i>					
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	01	01130	6020000	3535	40,000 mijë lekë
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	01	01120	6020000	3535	80,000 mijë lekë

Deputetët u interesuan mbi arsyet e kërkesave për ndryshime dhe shtesa në projekt-buxhetin për vitin 2020, si dhe mbi realizimet e deri më tanishme të të dyja ministrive në kuadër të shpenzimeve buxhetore. Pas shpjegimeve nga përfaqësuesit e ministrive dhe prezantimit të objektivave që pritet të realizohen me projekt-buxhetin për vitin 2020 së bashku me ndryshimet e kërkuara, deputetët i vlerësuan këto kërkesa të drejta dhe u shprehën dakord për përcjelljen e tyre komisionit përgjegjës.

- **PËRFUNDIME**

Në aspektin **ligjor**, projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin **procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin **formal**, projektligji përbëhet nga 3 krerë dhe 21 nene.

Në përfundim, nga studimi i projektligjit dhe relacionit shpjegues vërehet se:

Relacioni shoqëruar i projektligjit shpjegon në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara, financimet dhe realizimin e tyre.

Për projektbuxhetin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën në Komisionin vlerësoi të drejtë kërkesën për shtesa dhe u shpreh dakord për t`ia kaluar atë komisionit përgjegjës.

Për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisioni vlerësoi se projektbuxheti i plotëson nevojat në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2020, veç nevojës për disa ndryshime në tavanet buxhetore, të evidentuara më lart.

Pas diskutimesh në komision, **deputetët votuan nen për nen** buxhetin për Ministrinë e Shtetit për Diasporën dhe buxhetin për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe me votat e shumicës së anëtarëve e miratuan atë.

Raporti i dërgohet Komisionit për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit “ Për Buxhetin e vitit 2020”.

RELATORE

EGLANTINA GJERMENI

KRYETARE

MIMI KODHELI